

BAJRAM XHAFA

**DIBRA DHE DIBRANËT NË QËNDRESËN
E 7 PRILLIT 1939**

Mbasi dështoi me variantin e zbarkimit “paqësor” për pushtimin e Shqipërisë me anë të mashtrimeve, aq shumë të dëshiruar për Benito Musolinin, gjithashtu edhe me shantazhet e ultimatumet drejtuar qeverisë shqiptare në mars - prill 1939, kreut të fashizmit italian i mbeti të verë në zbatim mjetin e fundit, më të padëshiruarin e më të dëmshmin për të: agresionin ushtarak. Italia fashiste e mblodhi mendjen t’i hynte aventurës së luftës me legjionet e ushtrisë duke u detyruar të përdorë ato mjete, që po të përdorim një reference të diplomacisë angleze “e goditën rëndë ndërgjegjen e krishterë”. Duke shkelur në mënyrë flagrante marrëveshjet dypalëshe dhe ato ndërkombëtare, duke vepruar kundër vullnetit të popullit, të qeverisë shqiptare dhe çdo morali njerëzor, në mënyrë të pabesë e të paskrupullt, kreu i fashizmit italian dhe shteti italian ndërmori më 7 prill 1939 agresionin ushtarak kundër shtetit të pavarur shqiptar dhe Mbretërisë Shqiptare, kundër popullit e kombit shqiptar.

Ç’qëndrim mbajtën shteti shqiptar dhe shqiptarët si popull e si komb ndaj këtij agresioni? Objekti ynë i studimit është specifik: qëndrimi i popullsisë dibrane, shkalla e pjesëmarrjes dhe e mobilizimit të saj në qëndresën e 7 prillit.

Në sulmin ushtarak që po afrohej, nuk mund të mos merrej parasysh e kaluara. Dibranët llogariteshin si një burim i fuqishëm luftarak për rezistencën kundër armikut. Parinë dibrane, ashtu si gjithë parinë shqiptare, Mbreti Zog e kishte trajtuar me shumë kujdes. Disa prej tyre i trajtonte si ushtarakë në rezervë, me rroga sipas gradave ose me dhurata simbolike, duke siguruar prej tyre forca të rëndësishme vullnetare për nevojat emergjente. Potenciali luftarak i Dibrës ishte i provuar nga historia dhe i vlerësuar nga studiues të shumtë.

Në ngjarjen fatale të 7 prillit 1939, dibranët vinin me një arkiv shumë të pasur të historisë luftarake për mbrojtjen e vendit. Sidomos

dhjetëvjeçari i dytë i shekullit të ri që i jashtëzakonshëm për ngarkesën luftarake që përballuan dibranët. Në Luftërat Ballkanike, ata i gjeje me një numër të madh forcash tëc shpërndarë (1912-1913) ata, në numër të madh forcash i gjeje të shpërndarë njëkohësisht në të gjitha frontet që rrethonin tokat shqiptare: në Shkodër, në Kakarriq të Lezhës, në Kolesian të Lumës, në Manastir e në Follorinë, nga sulmuan ushtritë e rregullta të shteteve agresore të Serbisë, Malit të Zi e Greqisë etj.⁵⁷¹.

Në Luftën e Parë Botërore dhe pas saj, dibranët qenë protagonistë luftarakë të dorës së parë në përballjet ushtarake. Ata përbënin kontigjentin kryesor në batalionin që luftoi përkrah forcave të Antantës kundër Bllokut Qendror me komandant Halit Lleshin e Zogje⁵⁷². Edhe në luftërat dhe kryengritjet çlirimtare antiserbe në vitet '20, në Dibër e në Shkodër, dibranët ishin në ballë të luftës; madje edhe në Vlorë kundër ushtrisë italiane. Gjithashtu, në ngjarjet politike të viteve '20 ku lypsej ndërhyrja e forcave qeveritare (që bënë punën e milicisë) për stabilizimin e shtetit shqiptar që po ngrihej, e në vitet që pasuan, vullnetarët dibranë ishin të kudondodhur. Gjithë ai kontigjent luftëtarësh dhe prijësish dibranë, pjesëmarrës e protagonistë të atyre luftërave, në prag të 7 prillit, ende ishin gjallë. Të tjerë më të rinj, plot frymëzim patriotik e luftarak, i ishin shtuar veteranëve të luftërave kombëtare. Në luftën që fashizmi po përgatiste e ku Shqipëria projektohej të ishte ndër viktimet e para, Dibra dhe dibranët pritej të ishin rezerva luftarake e dorës së parë.

Edhe armiku ishte i vetëdijshëm për këtë potencial luftarak. Më 3 prill atashëu ushtarak në Tiranë, kol. D'Andrea shkoi në adjutanturën e Mbretit për të bërë presion duke deklaruar: “Jemi në dijeni se po mobilizohen vullnetarë në Mat, Dibër, Kthellë e në vende të tjera...Në është e vërtetë, për çfarë arsye bëhet ky mobilizim?”⁵⁷³, pyeti kërcënueshëm ai. Fillimi i agresionit të 7 prillit tregoi efikasitetin e organizimit shoqëror tradicional të shoqërisë dibrane. Tjetër gjë se

⁵⁷¹ Haki Stërmilli, *Dibra në prag të historisë*, dorëshkrim (kopje në Muzeun e Peshkopisë), 1940, f. 71-72; Ismail Strazimiri, *Kujtime historike mbi lëvizjet kombëtare në qarkun e Dibrës* (dorëshkrim), Tiranë, 1931, f. 2, 3; Gino Berri, *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë, 1998, f. 128, 151-153.

⁵⁷² Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë, 1995, f. 90; *Historia e Shqipërisë (1912-1944)*, vëll.III, Tiranë, 1984 f. 168.

⁵⁷³ *Mbreti Zog rrëfen...Kujtime*, gazeta “Korrieri”, nr. 16 (561), 22 janar 2003, f. 14.

mospërdorimi i kësaj force të “premtën e zezë” ndodhi për shkak të mungesës së funksionimit të strukturave komanduese shtetërore në organizimin ushtarak nga diversioni armik. Edhe një fakt tjetër, sulmi mbi Shqipërinë e vogël u krye nga një agresor i fuqishëm shumëfish më i madh, i cili përfaqësonte një shtet me ambicie globale, që shfrynte furinë e parë të egërsisë fashiste në një luftë që shpejt do të bëhej e përbotshme, më e madhja në historinë e deriatëhershme.

Ndonëse zonë e thellë dhe rruga e makinës ishte shumë e gjatë dhe e keqe (Peshkopi-Librashd-Elbasan-Tiranë), ndërlidhja e Dibrës me kryeqytetin mbahej me shumë rregull. Paria e Dibrës mbante kontakte të pandërprera me Tiranën, merrte e jepte informacione dhe e ndiqte situatën për afrimin e zbarkimit ushtarak të Italisë. Shumë informacione sekrete realizoheshin edhe nëpërmjet korrierëve, të cilët Tiranën e arrinin në këmbë brenda ditës. Gatishmëria luftarake dhe mobilizimi i forcave vullnetare në Dibër në prag të agresionit ka qenë ndër më të shkëlqyerat.

Ndërsa në Tiranë e qytete të tjera populli demonstronte kundër agresionit e kërkonte armë për të luftuar e vdekur për Atdhe e Mbret, nga fqinjët vinin kërcënime e forma të ndryshme diversioni e sabotazhi për të penguar qëndresën e shqiptarëve ndaj pushtuesit të përtejdetit. Prefekti i Dibrës, Kolë Mjeda, telegrafonte i alarmuar për propagandat e dëmshme që zhvillonin në masë agjentët jugosllavë për të futur dyshime në popullsinë e krahinës dhe për kërcënimet e komandës së ushtrisë jugosllave në Dibër se “po të bëhet diçka (rezistencë antifashiste-B.Xh.) ushtria jugosllave do të kalojë kufirin 15 kilometra brenda Shqipërisë, për të siguruar interesat e saj e qetësinë e vendit”⁵⁷⁴.

Kur u pa se nga Italia e Jugut së shpejti do të niseshin drejt Shqipërisë forcat fashiste, u dha alarmi dhe u lëshua thirrja “Atdheu në rrezik”. Mbreti çoi fjalë edhe në Dibër dhe gjithë paria e Dibrës, me “të vetët”, u nis për t’i dalë zot vatanit duke përfshirë këtu edhe kundërshtarët politikë të regjimit, si Cen Elezi. Mobilizimi, organizimi dhe drejtimi i fuqive luftarake u bë nga paria. Nga Dibra e Poshtme u nisën Kaloshët me 300 - 400 vullnetarë në drejtimin nga Qafë Murra në Burrel-Qafë-Shtamë për të dalë në Krujë e më tej drejt Tiranës, Durrësit e Shëngjinit⁵⁷⁵. Nga Muhurri u nisën Ramadan Hoxha (nipi i Dines) me

⁵⁷⁴ *Po aty*, nr. 19 (564), 25 janar 2003, f. 15.

⁵⁷⁵ Kujtime të marra nga veterani Ukë Dullë Cami (Viçisht, veteran, 72 vjeç), marrë nga autori më 11. 08. 1990.

muhurrakë dhe një pjesë luznakë (Lishan, Arape dhe më pak nga Katundi i Ri), rreth 40 vetë, Adem Pira me 20 - 30 vetë⁵⁷⁶ etj. Me këto u bashkuan edhe forcat e drejtuara nga Beqir Sina, oficer i Mbretërisë, ndonja 150 vetë, të cilat shkuan deri në Qafë Shtamë. Nga Kaloshët kanë qenë me forca: Selimi (i Sinës), Miftari, Osman Lita i Kalasë së Dodës, Dervish Lusha, Qazim Lusha, Haxhi Noka, (me 30-40 vetë. Selim Noka në këtë kohë kishte vdekur)⁵⁷⁷. Cen Elezi me vllazni, me Reç e Dardhë (dy Malet e Poshttra) dhe Ujë e m'Ujë, me mbi 300 forca kaluan nga Qafë Murra drejt Burrelit e Tiranës. Në Mat kanë marrë vesh se Mbreti ishte larguar nga Tirana⁵⁷⁸.

Vullnetarët i kanë pasur armët në shtëpi. Një pjesë e mirë është armatosur me armët që i ka shpërndarë paria, e cila kishte depo të fshehta armatimi. Mijëra fshatarë dibranë e matjanë u grumbulluan në Burrel ku shpërthyen depot ushtarake dhe me pushkët që morën aty, një pjesë prej tyre u nisën menjëherë drejt Durrësit e Shëngjinit⁵⁷⁹.

Nga Dibra e Epërme, nën drejtimin e majorit të mbretërisë Ukë Dan Cami, (i Sepetovës) mbi 300 forca u nisën në drejtimin Bulqizë-Qafa e Buallit-Qafa e Murrizës-Shkalla e Tujanit (ose Shkalla e Tiranës, siç i thoshin dibranët që kalonin shumë atë rrugë si qiraxhinj, nga ku edhe rruga e tyre e hyrjes në Tiranë u quajt "Rruga e Dibrës"). Gjithashtu Ali Maliqi (Agolli) i Kërçishtit nga paria e Topalltisë (Fusha e Dibrës) me 500-600 forca u nis drejt Durrësit për ta pritur me zjarr ushtrinë italiane.

Nga Demallarët në krye të fuqive vullnetare për zonën u vunë Demir Dema e Shaqir Dema. Më 4-5 prill në fushë "Mizinë" të fshatit Homesh u bë grumbullimi, pranë shtëpisë së Dine Demës, i cili u "jepte muhabet" dhe bënte sqarimet e duhura për situatën. Burra të ardhur nga malësia dhe fusha, veshur me rroba kombëtare, në gatishmëri për t'u nisur për luftë "rrinin të ulur këmbëkryq duke ndjekë e stërhjekë kuvendin sipas zakonit të maleve. Ata dukej luanin nëpër gishta historinë, duke përmendur disa herë dhe Luftën e Vlorës, kur italianët iknin si

⁵⁷⁶ Kujtime të mbledhura nga Xhemal Berisha, arsimtar nga Muhurri mbi 80 vjeç, dhënë autorit më 29. 07. 2007.

⁵⁷⁷ Musa Beqir Sina, kujtime të marra nga autori më 8 tetor 1992.

⁵⁷⁸ Remzi Ndreu, i datëlindjes 1928, pjesëtar i familjes së madhe Ndreu, i persekutuar nga regjimi komunist, aktualisht deputet (kujtime të marra nga autori më 03. 05. 2007).

⁵⁷⁹ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar*, vëll. I (prill 1939 - dhjetor 1942), Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1984, f. 98.

lepuj”⁵⁸⁰. Më 6 prill, mbi 700 vullnetarë civilë nisen në këmbë nga Homeshi në drejtim të Tiranës, të prirë nga Demir Mersim Dema e Shaqir Dema. Fuqinë më të madhe e kishte Demiri, i cili ishte nisur më përpara, kurse Shaqir aga, tashmë i moshuar, hipur në kalë shale, i printe një fuqie prej 70-80 forcash. Habe Leka nga katundi Zogje shkoi me 30-40 vetë⁵⁸¹. U nisën edhe njësite më të vogla luftarake në bazë fshati. Rexhep Krosi nga Bllaca, një nacionalist i zjarrtë, oficer i Mbretërisë u nis drejt Durrësit me 10-12 bashkëfshatarë të vet⁵⁸². Të prirë nga paria, vullnetarët dibranë morën rrugën në drejtim të Bulqizës, Qafë-Buallit, Klosit, Gurit të Bardhë, Qafë Murrizës, Shkallë të Tujanit për t’u përqendruar në Tiranë. Kjo ishte edhe rruga tradicionale më e shkurtër e këmbësorëve dhe karvaneve të qiraxhinjëve që lidhte Tiranën me Dibrën, e njohur që nga mesjeta si “Rruga e Arbërit”.

Forca të tjera vullnetare u nisën drejt Gollobordës, Librazhdit dhe Elbasanit, edhe ato për t’u grumbulluar në Tiranë e Durrës e për t’u përballur me ushtrinë e huaj që ishte nisur të pushtonte atdheun e tyre⁵⁸³.

Shqiptarët në përgjithësi dhe dibranët në veçanti treguan gatishmëri të lartë luftarake dhe vendosmëri për të mbrojtur atdheun e për të sakrifikuar për të. Ata “rrokën hutat” si moti dhe mbi 2000 vullnetarë dibranë u nisën për luftë. Po deri ku shkuan dhe si u përdor kjo forcë; ç’u bë më pas me to?

Politika me theks kombëtar që pati ndjekur Mbreti Zog kishte dhënë rezultate të shkëlqyera për bashkimin kombëtar, sa edhe kundërshtarët e tij e pranojnë. Tajar Zavalani shkruan: “U dha kushtrimi “Atdheu në rrezik” dhe të gjithë shqiptarët, me pak përjashtime, u treguen gati me rrëmbye pushkën për me e mbrojtë. Çdo gja tjetër u harrue; cmiret, nakaret, padrejtësit, pësimet e kaq vjetve u përulanë nga dishiri i flaktë mos me lanë Shqipninë të bjeri përsëri nën zgjedhën e huej. Në ankthin e ditve të para të prillit u farkue bashkimi i shenjtë dhe spontan i

⁵⁸⁰ Kadri M. Dema, *Fisi Dema nëpër breza*, “Votra”, Shkup, 2003, f. 127.

⁵⁸¹ Ukë Dullë Cami (Viçisht, veteran, 72 vjeç), tregime gojore, marrë nga autori më 11.08.1990; Liman Xhafa (Kovashicë, veteran i Luftës Antifashiste, 78 vjeç), marrë më 1992.

⁵⁸² Osman Leka, arsimtar, njohës i mirë i historisë dhe zakoneve të vendit, i datëlindjes 1928 (marrë nga autori më 2008).

⁵⁸³ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të qarkut Dibër* (maket), 1969, f. 13. Kujtime veteranësh të marra nga autori.

kombit shqiptar për të mbrojtë lirin e tij”⁵⁸⁴. “Populli me gjithë shpirt thërret e kërkon armë për t’u armatosur për të vdekur për Atdhe e Mbret. Por, çfarë të bënin...?”⁵⁸⁵.

Strukturat mbrojtëse të shtetit shqiptar mjerisht nuk funksionuan si duhet. Kujdesi i tepruar i Mbretit me politikën e faljeve edhe të krimeve kundër shtetit për hir të ruajtjes së ekuilibrave regjionale, fetare, krahinore etj., me synim ngjizjen e bashkimit kombëtar tek shqiptarët, çoi në atë pikë, sa në një çast emergjent si ky të mos funksiononte si duhet faktori detyrues i shtetit. Funksioni mbrojtës i shtetit, një ndër dy funksionet bazë të tij, çaloi. Organizimi, rregulli, komanda munguan. Qeveria nuk shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe nuk kishte bërë përgatitje për mbrojtjen ushtarake të vendit. Ushtria nuk mori ndonjë urdhër për veprim, por u çorientua. Po kështu forcat e xhandarmërisë dhe ato të kufirit. Nuk kishte bashkëveprim e harmoni midis qeverisë, komandës së Mbrojtjes Kombëtare, ministrisë së Brendshme. Agjencia italiane kishte pasur mjaft suksese në rekrutimin e nëpunësve, ministrave e deputetëve, të cilët në pjesën më të madhe pranuan në heshtje ultimatumet e Musolinit.

Udhëheqja e lartë shtetërore u përfshi nga paniku dhe tradhëtia e hapur. Më 6 prill 1939, prefekti i Durrësit Mark Kodheli braktis punën dhe shkoi në Itali për t’u kthyer me forcat pushtuese. Adjutanti i Mbretit gjeneral Zef Serreqi, i dërguari i jashtëzakonshëm në Itali, telegrafoi që andej dorëheqjen nga funksionet e shtetit shqiptar, për t’u kthyer nga Italia më 8 prill, në Tiranën e sapo pushtuar nga ushtria fashiste, duke shoqëruar kontin G. Çiano dhe për t’i dorëzuar atij në mënyrë simbolike kryeqytetin e Shqipërisë. Po më 6 prill, kryekomandanti i Mbrojtjes Kombëtare jep dorëheqjen. Shefi i shtabit të Ushtrisë dhe zëvendësi i tij (të dy austro-gjermanë) nuk dihej se për cilin punonin. Komanda e zonës III me n/kolonel Faik Qukun dhe komandanti i batalionit të xhandarmërisë së Beratit major Mahmut Golemi, nuk përgjigjeshin për të raportuar për detyrat. N/kolonel Bilal Nivica, caktuar nënkomandant i zonës IV të mbrojtjes Vjosë-Sarandë, nuk u paraqit fare në detyrë dhe as nuk dihet se ku ndodhet, lajmëronte komandanti i zonës mbrojtëse Ali

⁵⁸⁴ Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, botimi i dytë: Phoenix & Shtëpia e Librit, 1998, f. 305.

⁵⁸⁵ H. Selmani, *Mbreti Zog rrëfen...*, gazeta “Korrieri”, nr. 19 (564), datë 25 janar 2003, f. 15.

Riza Kosova. Qark/komandanti i xhandarmërisë së Gjirokastrës major Gjek Marashi, i familjes së bajraktarit të Shkrelit, kishte burgosur prefektin e Gjirokastrës, nëpunësit e prefekturës, kishte ulur flamurin shqiptar dhe ngritur atë italian. Pastaj liroi të burgosurit dhe i armatosi, duke i përdorur bashkë me forcat e xhandarmërisë që komandonte, kundër forcave kombëtare. Kur kapiteni dibran Haxhi Xhilaga (nga Deshati) pas tërheqjes nga Saranda me forca të pakta po sistemonte vijat e dyta të mbrojtjes mbi Delvinë, ai sulmohet prapa krahëve nga majori tradhëtar me batalionin e xhandarmërisë⁵⁸⁶. Në ndeshjet e para që u bënë në afërsi të Jergucatit, si major Gjek Marashi dhe Gjergj Marka Gega kanë mbetur të vdekur e batalioni u shpërnda⁵⁸⁷.

Dhamë disa shembuj të qëndrimeve të rënda e të konfuzionit që sundonte në instancat e larta të shtetit. Episode të ngjashëm në nivele më të ulta kishte shumë. Në këto kushte edhe gatishmëria e popullit për qëndresë mbeti vetëm në mundësi, si një fuqi potenciale. Adjutanti i Mbretit shkruan se Mbreti parashikonte një kundërmësymje për t'i hedhur në det agresorët me rezervat që kishte komanda, por "nga 6 000 kreshnikë Mat-Dibër e Mirditë... ende nuk kishin arritur gjithë këto rendime, të cilat duhet të ishin të gatshëm për të mësy në Yzberish, Limuth, Prezë, me drejtim Durrës-Kavajë. Komanda e Mbrojtjes Kombëtare ishte tepër e shqetësuar, sepse nga thirrjet që u bënë komandave të zonave, nuk merrte asnjë përgjigje...Vetëm sa u përket kreshnikëve me të gjitha kolonat, si: Burrel, Derven, Shtamë, Murrizë që marrshojnë me shpejtësi, saqë mbrëmja ka për t'i zënë duke arritur"⁵⁸⁸.

Por të mbetur pa drejtim e pa organizim, ato u detyruan të kthehen në mes të rrugës pa arritur në destinacion. Ndërsa ata vazhdonin marshimin, pasditen e 7 prillit qielli u përshkua nga avionë që kalonin me uturimë valë-valë duke hedhur fletushka, në të cilat i bënin thirrje popullsisë për të mbajtur qetësi. Në Qafë të Murrizës, një grup vullnetarësh nga Dibra e Epërme takojnë të rinj-nxënës e qiraxhinj që ktheheshin nga Tirana, të cilët u treguan se italianët kishin zbarkuar në Durrës e se çdo gjë kishte marrë fund. Kjo bëri që ata të kthyen

⁵⁸⁶ *Po aty*, nr. 21 (566), 28 janar 2003, f. 15.

⁵⁸⁷ Hysen Selmani, *Nga notimet e Zogut I Mbretit të shqiptarëve*, Tiranë, 2008, f. 369.

⁵⁸⁸ *Po aty*, f. 368.

mbrapa⁵⁸⁹. Të tjerët u kthyen, kush nga Ura e Vashës (midis Klosit e Gurit të Bardhë), kush nga Tujani, Fushë-Kruja, Qafë Shtama, Burreli etj. Kështu vullnetarët dibranë u kthyen në shtëpitë e tyre.

Dita e zezë e 7 prillit qe një gur prove për qeverinë dhe qeveritarët, komandantët dhe oficerët, ushtarët e rezervistët, për vullnetarët, krahinat, kategoritë shoqërore, për të gjithë shqiptarët. Më 7 prill dibranët lanë emër të mirë para atdheut e popullit. Ata treguan ndjenjë të lartë atdhedashurie e vetmohimi, gatishmëri të lartë luftarake e përgjegjësi në kryerjen e detyrës ushtarake e ardhetare.

Shumë dibranë, njerëz të thjeshtë të popullit e treguan atdhedashurinë e tyre të zjarrtë kudo që u ndodhën, duke luftuar e rënë heroikisht me armë në dorë kundër invadorit të huaj. Për mbrojtjen e Durrësit, ditën e 7 prillit 1939, nga dibranët u vranë duke luftuar heroikisht kundër ushtrisë armike që zbarkonte: Isak Metalia nga fshati Strikçan (Grykë e Madhe), ushtarët e Mbretërisë, Hajdar Koçi dhe Ibrahim Osmani. Isaku kishte shkuar në Durrës për të punuar si hamall porti ose merrej me ndonjë punë të rastit për të mbajtur familjen e tij në Dibër. Ditën e zbarkimit të ushtrisë italiane në portin e Durrësit, ai kishte zënë pozicion në një shtëpi që kontrollonte pamjen mbi sheshin e bashkisë së qytetit. Kur një oficer e këshilloi ta linte pozicionin e të tërhiqej, mbasi çdo qëndresë e mëtejshme ishte e kotë, Isaku iu përgjigj me një vendosmëri që nuk linte shteg për debat: “Unë e kam da mendjen me mbetë këtu. U thoni fëmijëve të mi se vdiqa për Shqipërinë” dhe vazhdoi të luftonte aty së bashku me një ushtar, që edhe ai nuk pranoi të tërhiqej. Të dy bashkë, ata e kthyen shtëpinë në fortifikatë, duke u bërë një pengesë e pakapërcyeshme për ushtarët italianë. Shtëpia u qëllua me mortaja. Dy luftëtarëve iu bënë thirrje të dorëzoheshin, por ata vazhduan qëndresën derisa ranë të përfshirë nga flakët e shtëpisë, të cilën fashistët e bombarduan edhe nga lart me anë të një avioni luftarak të dërguar posaçërisht⁵⁹⁰.

⁵⁸⁹ H. Selmani, *Mbreti Zog rrëfen...*, gazeta “Korrieri”, nr. 20, f. 15; Kadri M. Dema, *Fisi Dema nëpër breza*, “Votra”, Shkup, 2003, f. 128.

⁵⁹⁰ *Yje të pashuar*, vëll. III, Tiranë, 1974, f. 7-8. Veterani 95 vjeçar (më 1995) Myslim Tush Shehu nga Zerqani, ish oficer i Mbretërisë Shqiptare dhe pjesëmarrës në qëndresën e 7 prillit në Durrës tregon: Ne oficerave na mblodhi Abaz Kupi, qark/komandant i xhandarmërisë në ndërtesën ku ishte shkolla e xhandarmërisë. Po aty ishte edhe burgu politik. Bazi na caktoi detyrat luftarake, tregon veterani. Të gjithë oficerët, tha ai, do të marrin pjesë në luftë dhe familjet e tyre nuk do ti luajnë

Rreth orës 8-9 të mëngjesit, kryetari i bashkisë së Durrësit, dibrani Rustem Ymer Skënderi doli në ballkonin e bashkisë dhe mbajti një fjalim përpara popullit që ishte grumbulluar atje, ku dënoi hapur pushtimin fashist të Shqipërisë dhe foli ashpër kundër prefektit të Durrësit Mark

nga Durrësi që të mos tronditet populli. Unë vetë e kisha familjen aty, tregon Myslimi. Fronti ynë ishte prej Bankës deri aty ku sot është hotel "Vollga". Bashkia kishte ba një mur për të mbrojtur bahçen, mur i cili na vlejti shumë se aty ren(d)itëm (rreshtuam) mitralozët. Topat ishin pa gjilpana sepse ua kishin hequr italianët që shërbenin pranë Marinës sonë. Kur të zbresin italianët, na tha Bazi, mos u ngutni të shtini, por prisni të dalin sa më shumë ushtarë në mol, pastaj kur të jepet sinjali i zjarrit, filloni. Mujo Ulqinaku kishte një mitraloz kundra/ajror. Tirana na lajmëroi se kishte çuar dy topa, të cilët kishin mbërritur deri në Vorë, por me urdhër (të komandës së xhandarmërisë) i ndaluan aty. Mark Kodheli (prefekti) iku në aksham, para se të vinin italianët. Unë isha në mol. Pasi filloi zbarkimi dhe u mbush moli me ushtarë, u dha sinjali dhe filloi lufta, por ata ishin shumë. U tërhoqën në anije dhe pastaj filloi bombardimi. Bazi liroi të burgosurit politikë dhe bashkë me kursantët e shkollës së xhandarmërisë u bë një sulm i ri. Tri herë i kemi kthyer italianët mbrapsht në anije.

Isak Metalia ishte punëtor që e pata shti në doganë si punëtor krahu. Isakut i lashë pushkën (një pushkë austriake), sepse mitralozin, më tha, nuk di ta përdori. Ne nuk dorëzohemi, shtoi ai. Në këtë kohë vjen Rifat Manjani (nga fshati Homesh, dëshmor, vrarë bashkë me Vasil Shanton e Reshit Rusin në Vrakë të Shkodrës në shkurt 1944) dhe më thotë që t'i nxjerrim familjet jashtë qytetit sepse gjendja asht e rrezikshme. I nervozuar i them: po si e kemi urdhnin, mor burrë? - Mor, mos shiko urdhnin se kjo punë e pat, por të nxjerrim prej këndeje e të shpëtojmë fëmijët. - Me se do t'i nxjerrim, ku të gjejmë makinë? - E gjej unë makinën, tha Rifati. Në Elbasan kisha nipin tim Ahmet Cami, që ishte komandant grupi. I nisëm familjet për Elbasan, në Polis. Pastaj u tërhoqëm edhe vetë, por mbetëm të rrethuar. U ktheva drejt legatës angleze që të dorëzohem aty. Ndërkohë kujtohem për Isak Metalinë dhe Dan Velin. Unë të sigurohem, thashë me vete, e të la shokët? U ktheva në shtëpi, por atë ma kishin bombarduar. Isaku dhe Dan Velin janë bombarduar në shtëpinë time, tha 95 vjeçari. Italianët e lanë të lirë urën e Dajlanit si shteg që ne të tërhiqeshim. 300 - 400 burra, civila e oficerë, xhandarë, ushtarë etj. kaluan kufirin. Unë shkova në Gostivar, por Italia protestoi tek qeveria jugosllave dhe ajo na shpërndau.. Më çuan në Foça, ku më gjeti 7 prilli i vitit 1941. Pastaj shkuam në Mitrovicë, tek Sherif Voci. Atë ditë Gani Kryeziu, Hilli, Baz Kupi e Mustafa Gjinishi ishin nisur me forca për Shkodër. Dëshën të ngrenë flamurin e rezistencës në Kalanë e Shkodrës vetëm për një dekok (minutë), sa për shenjë të fillimit të rezistencës, por Italia kishte organizuar me forca Preg Calin, i cili nuk i la.

Kodheli, i cili kishte dalë në port për të pritur me lule pushtuesit italianë⁵⁹¹.

Dibrani tjetër, Kadri Rustem Bardulla nga Peshkopia, duke qenë në funksionin e komandantit të Mbrojtjes Bregdetare të zonës së Durrësit, ishte një ndër oficerët që u mor me organizimin e rezistencës që iu bë italianëve në momentin e zbarkimit. Që nga dy prilli ai nuk u kthye më në shtëpi, por qëndroi në Bisht Pallë e Shëngjin ku inspektonte trupat ushtarake që kishin marrë urdhër gatishmërie për të qëndruar në pozicione. Kadriu ndihmoi në përgatitjen e planit për mbrojtjen e Durrësit. Nuredin Pustina në kujtimet e tij shkruan: “Unë u bashkova me rojet e kufirit, nën komandën e komandantit të Kufirit, kapiten Kadri Rustemit nga Peshkopia. Kadriu mori në telefon kapiten Akil Sakiqin, i cili ishte komandant batalioni dhe i thotë se italianët kishin zbritur në tokë (mol) dhe kishin filluar të ecnin drejt nesh. Kompania kishte zënë pozicione afër godinës së Bankës, fare pranë molos. Me që në atë kohë lidhja telefonike me Tiranën ishte prerë, Kadri Rustemi nxorri revolen dhe qëlloi i pari. Kjo ishte shenja e sinjalit të luftës që jepte urdhërin për të hapur zjarr ndaj italianëve dhe menjëherë pas sinjalit të Kadriut, të gjitha repartet kudo që ishin dislokuar nëpër pozicione filluan të hapnin zjarr në drejtim të italianëve. Si rezultat i atij zjarri të pandërprerë, italianët u kapën në befasi pasi ata nuk e mendonin se do t’u bëhej rezistencë. Pas kësaj ata u tërhoqën dhe u mbyllën në anijet e luftës, por gjatë tërheqjes pati shumë të vrarë dhe të plagosur nga ana e tyre”⁵⁹². Kadri Rustemi ishte oficeri që dha i pari sinjalin e fillimit të zjarrit mbi ushtarët italianë që zbarkuan në tokë shqiptare.

Mul Deli Bajraktari, komandant i Batalionit “Deja”, dislokuar në vijën e dytë të mbrojtjes në kodrat e Shijakut, shkruan se Batalioni i Rojes Mbretërore të Kufirit “kishte në Durrës një kompani që komandohej nga kapiteni i dytë Kadri Rustemi nga Dibra. Kompania e Rojes Kufitare ishte pozicionue përpara Bankës Kombëtare e nëpër disa shtëpi deri në bulevard. Toga e Marinës, e komandueme prej kapter Mujo Ulqinakut, i cili qe vra trimnisht si hero tue luftue deri në pikën e fundit.

⁵⁹¹ Ramiz Fiçorri, *Ndërhyrja italiane në Shqipëri (1925-1939)*, “Koçi”, Tiranë, 2005, f. 211. Referuar në: “Gazeta Shqiptare”, datë 19 dhjetor 2002.

⁵⁹² Dashnor Kaloçi, *Kadri Bardulla, komandanti i 7 prillit që u shpall armik (kujtime)*, në: “Gazeta Shqiptare”, 31 korrik 2002, f. 12-13.

Ky ka pasë pozicionin ma të vështirë, krejt në ballë. E njajta gja edhe për Rojen e Kufinit”⁵⁹³.

Në raportimin telefonik nga Saranda, toger Taifur Dibra tregon vendosmërinë për të kryer detyrën duke luftuar e vdekur kundër pushtuesit, edhe pse e shihte se nuk kishte asnjë mundësi ta përballonte një armik aq superior: “Flota italiane hyri në portin e Sarandës dhe filloi shkarkimin në tokat tona. Kam në dispozicion vetëm një togë ushtarë të Rojes së Kufirit. Luftën e fillova. Kam për të bërë detyrën për të vdekur për Mbret e Atdhe. Rroftë Mbreti e rroftë Shqipëria. Toger Taifur Dibra”⁵⁹⁴.

Në Dibër ushtria italiane arriti një javë pas pushtimit të Tiranës. Populli e priti ftohtë dhe i bojkotoi në mënyrë të hapur ceremonitë që organizuan disa krerë të parisë për të pritur ushtarët italianë. Me kaq u mbyll edhe akti i pushtimit ushtarak të Shqipërisë. Ashtu si për gjithë popullin shqiptar, edhe për Dibrën dhe dibranët filloi një “epokë” tjetër, një sundim i huaj, diktatura totalitare fashiste. Për dibranët, ashtu si për gjithë shqiptarët, dalin detyra të reja e mbahen qëndrime të ndryshme. Bashkë me këto lindin diferencime, ndarje, kundërvënie, qëndresa dhe luftëra nga format e thjeshta në ato më të larta e më të organizuara.

⁵⁹³ Mul Deli Bajraktari, *Besëlidhja e Malësisë së Madhe - Kujtime, 1939 - 1945*, Shkodër, 2004, f. 9.

⁵⁹⁴ H. Selmani, *Mbreti Zog rrëfen...*, Gazeta “Korrieri”, nr. 21 (566), 28 janar 2003, f. 14.

